

## **STATUTI I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**

### **"SORRIDI AL"- sh.p.k**

Sot, me date 17.06.2021, me deshiren dhe vullnetin e tyre te lire dhe te pavesuar shtetasit;

1. **Znj.Vilma Terpo**, lindur me 26.04.1986, ne Cerrik dhe banues ne Tirane, madhere me zotesi te plote per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi Shqiptare, e identifikuar me ane te kartes se Identitetit me nr. personal I65426012F ne cilesine e ortakut themelues .
2. **Z.Hajden Lulaj**, lindur me 04.10.1996, ne Polican, Skrapar dhe banues ne Tirane, madhor me zotesi te plote per te vepruar, me kombesi dhe shtetesi Shqiptare, i identifikuar me ane te kartes se Identitetit me nr.personal J61004006Q, ne cilesine e ortakut themelues

### **KRIJOJNE:**

Shoqerine me pergjegjesi te kufizuar **"SORRIDI AL"- sh.p.k.** Statuti eshte akti baze ku do te mbeshtetet themelimi i shoqerise tregtare **"SORRIDI AL"- sh.p.k** si dhe zhvillimi i metejshem i saj.

### **NENI 1**

#### **DISPOZITA TE PERGJITHSHME**

**1.1** Ortaket e kesaj shoqerie jane **Znj.Vilma Terpo** dhe zoteron 1 kuote ne vleren 51 % te kapitalit te shoqerise dhe **Z.Hajden Lulaj** i cili zoteron 1 kuote ne vleren 49 % te kapitalit te shoqerise.

### **NENI 2**

#### **EMERTIMI I SHOQERISE**

**2.1.** Shoqeria mban emrin **SORRIDI AL"** sh.p.k dhe eshte person juridik shqiptar. Shoqeria do te kete simbolet dhe vulen e saj personale.

**2.2.** Shoqeria **"SORRIDI AL"** sh.p.k, krijohet ne formen e nje shoqerie me pergjegjesi te kufizuar me dy ortake sic percaktohet ne nenin 1 te shoqerise , dhe veprimtaria e saj rregullohet me ane te ketij statuti.

**2.3.** Shoqeria vepron sipas legjislacionit shqiptar ne fuqi.

**2.4.**Statuti eshte ne perputhje me legjislacionin shqiptar qe ka karakter te detyrueshem, ndersa çeshtjet qe nuk jane shprehimisht te parashikuara ne to, rregullohen nga ligji "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare" dhe legjislacioni shqiptar si dhe ne kontrata respektive.

### **NENI 3**

#### **SELIA E SHOQERISE**

**3.1.** Shoqeria e ka seline qendrore ne Tirane, ne Rrugjen "Abdyl Frasher", ndertesa nr.8, shkalla c, kati 7 teknik, me siperfaqe 66.3 m<sup>2</sup>, e perbere nga zyra C-13 me nr.pasurie 4/251-N45, vol.67, fq.231, ZK8370, dhe gezon te drejten per te hapur filiale ose dege te tjera ne Shqiperi dhe jashte saj.

**3.2.**Njesite strukturore, deget dhe perfaqesite do te ndertohen konform legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe me ate te vendeve te tjera ku ajo mund te hape dege.

### **NENI 4**

#### **KOHEZGJATJA E SHOQERISE**

**4.1.**Shoqeria "SORRIDI AL"sh.p.k do te ushtroje aktivitetin ekonomik te saj, per nje periudhe kohe te pakufizuar nga data e regjistrimit te saj prane Q.K.B.

### **NENI 5**

#### **OBJEKTI I VEPRIMTARISE SE SHOQERISE**

**5.1** Aktivitet i telemarketingut (web call center), shitje online, prenotimi online, sherbim klienti etj.

**5.2** Qender prenotimi dhe sherbimesh turistike, ortodontike, etj.

**5.3** Aktivitet dhe analize statistike dhe konsultime te pergjithshme brenda dhe jashte Shqiperise.

**5.4** Si pjese e aktivitetit te saj shoqeria mund te financoj pale te treta , ose mund te marre financime dhe te kryej ndermjetsime dhe brokerime te c'do lloji, ne nivel kombetar dhe nderkombetar.

**5.5** Bashkpunimi me kompani e subjekte te te njejtes fushe si dhe ndermjetesime konsulenca per vendosjen e shoqerive te huaja ne Shqiperi.

**5.6** Projektimin, realizimin ose instalimin, dhe/ose mirembajtjene programeve kompjuterike, duke perfshire, por pa kufizuar: programme operative dhe/ose aplikative per desktop, web, dhe/ose mobile; dhe/ose sisteme "embedded".

**5.7** Projektimin, realizimin, dhe mirembajtjen e sistemeve dhe/ose aparaturave informatike, te telekomunikacionit, dhe/ose dixhitale.

**5.8** Projektimin, realizimin, dhe/ose mirembajtjen e sistemeve te sigurise informatike, telekomunikacionit, dhe/ose mbikqyrjes.

**5.9** Projektimin, realizimin, dhe/ose mirembajtjen/menaxhimin e regjistrave (baza te dhenash), trajtim te dhenash, duke perfshire, por pa kufizuar: realizimin dhe/ose tregtimin e te dhenave me pelqimin paraprak te testatorit te te dhenave; dhe/ose ngritjen dhe menaxhim in e call center(ave).

**5.10** Tregtimin e produkteve software dhe hardware duke perfshire, por pa kufizuar, per: sistemet informatike; sistemet e telekomunikacionit; dhe/ose sistemet dhe/ose aparaturave dixhitale.

**5.11** Gjithashtu shoqeria pa u kufizuar sa me siper, do te mund te kryeje çdo aktivitet tjeter ekonomik, tregtar, finanziar, qe gjykohet e nevojshme dhe e dobishme per realizimin e objektit te shoqerise qe nuk bie ne kundershtim me ligjin.

## **NENI 6**

### **PERGJEGJESIA E ORTAKEVE**

**6.1.** Pjesemarrja ne shoperi nuk pengon pavaresine ligjore, organizative dhe te pronesise se ortakeve.

**6.2.** Ortaku qe merr pjesë ne kete shoperi, nuk eshte perqegjes per detyrimet qe lindin gjate aktivitetit tregtar te shoqerise, tej kapitalit themeltar te saj, qe vete ai ka nenshkruar, gjithashtu shoqeria nuk perqigjet per detyrimet personale te ortakut te saj.

## **KAPITALI THEMELTAR, KONTRIBUTET, NDARJA DHE TRANSFERIMI I KUOTAVE**

### **NENI 7**

### **KAPITALI I SHOQERISE**

**7.1.** Kapitali i shoqerise "**SORRIDI AL**" sh.p.k perbehet nga para me nje vlore te barabarte me 10 000 leke. Pjesemarrja e themeluesve ne kapitalin e shoqerise eshte ne perputhje me kontributet e tyre te meposhtme:

**7.2** Ortaku themelues **Vilma Terpo**: Zoteruese i 1 (nje) kuote me vlore te per gjithshme 5 100 leke qe perben 51 % te kapitalit themeltar te shoqerise

**7.3** Ortaku themelues **Z.Hajden Lulaj**: Zoterues i 1 (nje) kuote me vlore te per gjithshme 4 900 leke qe perben 49 % te kapitalit themeltar te shoqerise..

**7.2.** Kapitali themeltar mund te rritet pa kufi ne çdo moment, nje ose disa here, me vendim te Asamblese se Pergjithshme.

**7.3.** Ne rast rritjeje te kapitalit, te gjithe ortaket kane te drejte te nenshkuajne rritjen ne raport me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre. Ne rast se nje apo disa nga ortaket nuk e ushtrojne kete te drejte, pjeset qe i rezervohen atij/atyre ne rritjen e kapitalit mund te nenshkuhen nga ortaket e tjere proporcionalisht me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

**7.4.** Shoqeria mund te zgjegoje kapitalin themeltar me vendim te Asamblese se Pergjithshme. Ne çdo rast kapitali themeltar nuk mund te zgjegojesh nen kufirin qe percakton ligji. Zgjedhimi i kapitalit perballohet nga secili prej ortakeve ne te njejtën mase me pjeset e kapitalit te zoteruara prej tyre.

## NENI 8

### TRANSFERIMI I KAPITALIT DHE I KUOTAVE

**8.1.** Kapitali themeltar ose pjese te veçanta te tij, jane te transferueshme nga ortaket tek te tretet. Transferimi i kapitalit apo pjesave te tij nga ortaku ne favor te te treteve, kryhet gjithnjë pas miratimit te tij me vendim dhe me akt notarial te posaçem.

**8.2.** Nese nje nga ortaket, qe mund te shtohen me vone ne shoqeri deshiron te shese kuotat e tij, ai duhet te respektoje te drejten e parablerjes ne favor te ortakeve te tjere te kesaj shoqerie.

**8.3.** Te gjitha veprimet e shoqerise qe kane te bejne me zmadhimin dhe zgjedhimin e kapitalit themeltar, qe te konsiderohen te vlefshme duhet te miratohen nga asambleja e per gjithshme e ortakeve.

**8.4.** Ne çdo rast vleresimi i kapitalit ne natyre qe zoteron apo do te krijoje shoqeria ne te ardhmen do te behet me vendim te Asamblese se Ortakeve ose nga nje ekspert kontabel i emeruar nga ortaku qe zoteron 1 kuote qe perben 51 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

## **NENI 9**

### **TRANSFERIMI I KUOTAVE**

**9.1.** Kuotat e kapitalit te shoqerise dhe te drejtat qe rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nepermjet:

- a) kontributit ne kapitalin e shoqerise;
- b) shitblerjes;
- c) trashegimise;
- ç) dhurimit;
- d) çdo menyre tjeter te parashikuar me ligj.

**9.2.** Ne rastin e kalimit te kuotave me kontrate, kontrata duhet te behet me shkrim.

**9.3.** Personi qe kalon kuoten dhe ai qe e fiton ate, per gjigjen ne menyre solidare ndaj shoqerise per detyrimet qe rrjedhin nga zoterimi i kuotes, nga çasti i kalimit te kuotave, deri ne çastin e regjistrimit te kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 te ligjit nr. 9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Regjistrimit". Regjistrimi i kalimit te kuotave ka efekt deklarativ.

## **NENI 10**

### **ORGANI VENDIMMARRES**

**10.1.** Organi vendimmarres i shoqerise eshte asambleja e per gjithshme e ortakeve. Çdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB-se per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

**10.2.** Asambleja e ortakeve, vendos per çeshqje si :

- a) percaktimi i politikave tregtare te shoqerise;
- b) emerimin dhe shkarkimin e administratoreve;
- c) emerimin e shkarkimin e likuiduesve dhe te eksperteve kontabel te autorizuar;
- ç) percaktimin e shperblimeve;
- d) mbikqyrjen e zbatimit te politikave tregtare nga administratoret, perfshire per gatitjen

e pasqyrave financiare vjetore dhe te raporteve te ecurise se veprimtarise;

- e) perfaqesimin e shoqerise ne gjykate dhe ne procedimet e tjera ndaj administratoreve;
- f) miratimin e rregullave procedurale te mbledhjeve te asamblese;
- g) ndryshimin e statutit, e selise se shoqerise, hapjen dhe mbylljen e filialeve te saj.
- h) zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te shoqerise;
- i) riorganizimin dhe prishjen e shoqerise etj.

**10.3.** Te gjitha vendimet e marra nga asambleja e per gjithshme duhet te regjistrohen ne librin e procesverbaleve sipas nenit 90 te ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare".

**NENI 11**  
**DREJTIMI I SHOQERISE**

**11.1.** Shoqeria do te drejtohet nga asambleja e per gjithshme e ortakeve dhe administratori i zgjedhur .

**11.2** Cdo kontrate do te kryhet prej tyre dhe ne rast mungese shoqeria do te perfaqesoitet nga administratori.

**NENI 12**  
**ASAMBLEJA E PER GJITHSHME E ORTAKEVE**

**12.1** Asambleja e Perjithshme thirret nepermjet nje njoftimi me shkrese ose me njoftim me poste elektronike.

**12.2** Njoftimi duhet te permbate vendin, daten, oren e mbledhjes dhe rendin e dites dhe tu dergohet ortakeve jo me vone se 7 dite perpara dates se parashikuar per mbledhjen e asamblese.

**12.3** Asambleja e per gjithshme vendos me tri te katertat e votave te zoteruesve te kapitalit, te ortakeve pjesmarres, per ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogelimin e kapitalit te regjistruar, shperndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqerise.

**12.4** Asambleja e per gjithshme vendos me shumice te votave te ortakeve pjesmarres, per cesh tjete te tjera si:

- a) Percaktimin e politikave tregtare te shoqerise.
- b) Emerimin dhe shkarkimin e administratoreve.
- c) Emerimin dhe shkarkumin e likuiduesve dhe eksperteve kontabel te miratuar.

- d) Percaktimin e shperblimeve.
- e) Mbikqyrjen e zbatimin e politikave trgtare nga administratoret, perfshire perqatjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve te ecurise se veprimitarise.
- f) Perfaqesimin e shoquerise ne gjykate dhe ne procedurat e tjera administrative
- g) Miratimin e rregullave proceduriale te mbledhjeve te asamblese.

**12.5 Asambleja e Perjithshme emeron nje ose me shume persona fizik si administrator te shoquerise . Afati i emertimit eshte 2 vjet me te drejte riperteritje. Emertimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit ne Qendren Kombetare te Regjistrimit.**

**12.6 Ortaket themelues unanimisht vendosin te caktojne si Administrator te pare te shoquerise "Sorridi AL" shpk deri ne mbledhjen e pare te asamblese se perjithshme:**

**Znj.Vilma Terpo**

**NENI 13  
KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT**

**13. Administratori ka te drejte dhe detyrohet te :**

**13.1 Kryeje te gjitha veprimet e administrimit te veprimitarise tregtare te shoquerisr, duke zbatuar politikat tregtare, te vendosura nga asambleja e perjithshme.**

**13.2 Te perfaqesoje shoqerine tregtare, te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumentave dhe librave kontabel te shoquerise.**

**13.3 Te perqatise dhe nenshkruaje bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurise se veprimitarise sebashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve duke i paraqitur keto dokumenta perpara asamblese se perjithshme per miratim.**

**13.4 Te krijoje nje sistem paralajmerimi ne kohen e duhur per rr Ethanat qe kercenojne mbarvajtjen e veprimitarise dhe ekzisten e shoquerise.**

**13.5 Te kryeje regjistrimet dhe te dergoje te dhenat e detyrueshme te shoquerise sic parashikohen ne ligjin per QKB.**

**13.6 Te raportoje perpara asamblese se perjithshme ne lidhje me zbatimin e politikave**



tregtare dhe realizimin e veprimeve te posacme me rendesi te vecante per veprimtarise e shoqerise tregtare.

**13.7 Te kryeje detyrat e tjera te percaktuara ne ligj dhe ne statut.**

**NENI 14**  
**PERGJEGJESITE E ADMINISTRATORIT**

**14.1** Administratori eshte pergjegjes individualisht ndaj shoqerise ose ndaj te treteve per shkelje te ligjeve, statutit apo per faj te kryera gjate administrimit te shoqerise.

**14.2** Pasojat e marreveshjeve te pamiratuara nga asambleja qe i sjellin dem shoqerise i ngarkohen administratorit dhe ortakut qe ka bere marrveshjen per te perballuar ne menyre individuale ose solidarisht pasojat perkatese.

**NENI 15**  
**EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR**

**15.1.** Kontrolli i shoqerise kryhet nga nje ekspert kontabel i autorizuar, i emeruar per 1 vit financiar, me mundesi rizgjedhjeje. Shkarkimi i ekspertit kontabel te autorizuar vendoset ne te njejtat kushte si emerimi, ne rast se kryhen shkelje, verehen gabime ose behet e pamundur kryeja e detyres.

**NENI 16**  
**VITI FINANCIAR**

**16.1.** Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor.

Llogarite vjetore, inventari, raportet mbi operacionet e vitit financiar dhe raportet e vecanta hartohen dhe miratohen nga Administratoria **Znj. Vilma Terpo** e cila eshte edhe organi i vetem vendimmarres i shoqerise .

**NENI 17**  
**BILANCI I SHOQERISE DHE DIVIDENTET**

**17.1.** Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Administratoria **Znj. Vilma Terpo** e



cila eshte edhe organi i vetem vendimmarres i shoqerise .miraton bilancin .

**NENI 18**  
**MBARIMI I SHOQERISE**

**18.1.** Shperndarja ose prishja e shoqerise mund te behet ne çdo kohe :

- a) kur mbaron kohezgjatja e parashikuar ne themelimin e saj;
- b) me vendim te Ortakut Znj. Vilma Terpo;
- c) me hapjen e procedurave te falimentimit;
- ç) nese nuk ka kryer veprimtari tregtare per dy vjet dhe nuk eshte njoftuar pezullimi i veprimtarise ne perputhje me piken 3 te nenit 43 te ligjit nr.9723, date 3.5.2007 "Per Qendren Kombetare te Registrimit";
- d) me vendim te gjykates;

**18.2.** Ne kete rast asambleja e per gjithshme merr vendim me shkrim ne te cilin parashikon menyren e likuidimit te shoqerise, duke caktuar nje apo disa likuidatore dhe shenuar ne çdo dokument te nxjerre prej saj emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese "*Shoperi ne likuidim e siper*".

**18.3.** Prishja e shoqerive tregtare ka si pasoje hapjen e procedurave te likuidimit ne gjendjen e aftesise paguese, me perjashtim te rasteve kur eshte nisur nje procedure falimentimi.

**18.4.** Likuidimi kryhet nga likuiduesit, te emeruar nga Ortaku Znj. Vilma Terpo.

Nese Ortaku nuk merr nje vendim per emerimin e likuiduesve, brenda 30 diteve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykates, per te caktuar nje likuidues.

**NENI 19**  
**TRANSFORMIMI I SHOQERISE**

**19.1.** Transformimi i shoqerise behet me vendim te asamblese se per gjithshme te ortakeve ose kur ekzistojne faktore te jashtem detyrues ligjore, ne keto raste vendimi merret pasi i eshte paraqitur asamblese nje raport mbi gjendjen e shoqerise nga ana e administratorit.

**19.2.** Çdo transformim i bere ne kundershtim me kete nen eshte i pavlefshem.

**NENI 20  
BAZA LIGJORE**

**21.1.** Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te pote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

**22.2.** Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit nr.9901, date 14.04.2008 "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

**NENI 21  
MOSMARREVESHJET**

**21.1.** Per mosmarreveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarreveshje qe mund te linde midis Shoqerise dhe te treteve, do te tentohet te zgjidhen me konsensus dhe mirekuptim.

**21.2.** Ne rast te kundert kompetente per zgjidhjen e mosmarreveshjeve do te jete Gjykata e Rrethit Gjyqesor Tirane.

**NENI 22  
DISPOZITA PERFUNDIMTARE**


Ky Statut u redaktua ne 4 kopje ne gjuhen shqipe, ne 10 (dhjete) faqe gjithsej me vlere te njejte juridike.

**ORTAKET**

**VILMA TERPO**

  
Vilma Terpo

**HAJDEN LULAJ**

  
Hajden Lulaj